

VENDIM
Nr. 235, datë 22.9.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SMART TRADE & CONSULTING” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 173, DATË 26.10.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13, si dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/3 prot., datë 19.9.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Smart Trade & Consulting’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Smart Trade & Consulting” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 389, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Bazuar në kërkesën dhe aplikimin e shoqërisë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 215, datë 24.8.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Smart Trade and Consulting” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës të nisur me vendimin nr. 215/2022, në datat 25.8.2022 dhe 26.8.2022. Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 8.9.2022), nuk ka rezultuar që të ketë të tilla. Gjithashtu, me shkresën nr. 1384/2 prot., datë 25.8.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/3 prot., datë 7.9.2022, shoqëria “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të sa depozituar, rezulton se mbetet ende informacion/dokumentacion për t’u depozituar, ndaj ERE-s iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1384/4, datë 15.9.2022. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/5 prot., datë 19.9.2022, shoqëria ka plotësuar dhe pjesën e mbetur të dokumentacionit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 389, seria T17, të shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 27.10.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti